



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO**  
**GJYKATA SUPREME**

---

Numri i lëndës: 2021:004985  
Datë: 22.11.2024  
Numri i dokumentit: 06492272

Rev.nr.477/24

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Rrustem Thaqi, kryetar i kolegjit, Nenad Lazic dhe Zenel Leku, anëtar të kolegjit, në çështjen juridike - kontestimore të paditësve: H. Y., F. Y., S. Y., R. Y. dhe V. Y., nga S. e E., Komuna e V., të cilët i përfaqëson Ajvaz Islami avokat në V., sipas autorizimit, kundër të paditurës: Komuna e Vitisë - Drejtoria për Administratë dhe Personel, të cilin e përfaqëson Albulena Haxhiu, Përgjegjëse e Zyrës Ligore të e paditura, sipas autorizimit, për kompensimin e dëmit jomaterial, duke vendosur lidhur me revizionin e paditësve të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës Ac.nr.1848/2022, të datës 18.07.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur më datë 19.11.2024 mori këtë:

**A K T V E N D I M**

Pranohet revizioni i paditësve: H. Y., F. Y., S. Y., R. Y. dhe V. Y., nga S. e E., Komuna e V., Prishen aktgjykimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës Ac.nr.1848/2022, i datës 18.07.2024, dhe aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjilan - Dega në Viti, C.nr.19/2021, i datës 08.02.2022, dhe çështja i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim.

**A r s y e t i m**

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Gjilan - Dega në Viti, C.nr.19/2021, të datës 08.02.2022, është vendosur: I. Refuzohet si e pabazuar kërkesëpadia e paditësve H., F., S., R. dhe V. Y., të paraqitur kundër të paditurës Komuna e Vitisë - Drejtoria për Administratë dhe Personel, me të cilën kanë kërkuar të detyrohet e paditura që paditësve, në emër të dhimbjeve shpirtërore për të gjitha format, për shkak të cenimet të nderit, lirive dhe të drejtave të njeriut, t'ia kompensojë në këtë mënyrë: paditësit H. I., shumën prej 95, 000 €, paditëses F. I. shumën prej 95, 000 €, paditëses S. Y., shumën prej 35, 000 €, paditëses R. Y., shumën prej 35, 000 €,

dhe paditësit V. Y., shumën prej 35, 000 €, më kamatë ligjore prej 8%, nga data e nxjerrjes së aktgjykimit, në afat prej 15 ditësh, nën kërcënim të përmbarimit. IL Secila palë i bartë shpenzimet e veta të procedurës.

Me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës Ac.nr.1848/2022, të datës 18.07.2024, është vendosur: Refuzohet si e pabazuar ankesa e paditësve H., F., S., R. dhe V. Y., nga S. e E., Komuna e V., ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjilan - Dega në Viti, C.nr.19/2021, të datës 08.02.2022, vërtetohet.

Kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit, në afat ligjor kanë paraqitur revizion paditësit, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të aprovohet si i bazuar revizioni i paditësve, ashtu që të priset në tërësi aktgjykimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë Ac.nr.1848/2022 i datës 18.07.2024 dhe aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjilan - Dega në Viti C.nr.19/2021 i datës 08.02.2022, dhe çështja i kthehet në rigjykim dhe rivendosje gjykatës së shkallës së parë.

Përgjigje në revizionin e paditësve nuk ka pasur.

Gjykata Supreme e Kosovës, në procedurën e vendosjes sipas revizionit në kuptim të dispozitave të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) nga neni 211, 212 dhe 215 gjeti se:

Revizioni i paditësve është i bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësit, në gjykatën e shkallës së parë më datë 06.05.2014, kanë paraqitur padi, kundër të paditurës, me të cilën kanë kërkuar kompensimin e dëmit jomaterial, duke kërkuar më saktësisht si në seancën e datës 20.12.2021.

Gjykata e shkallës së parë, duke vendosur sipas padisë së paditësve, kundër të paditurës, pas vlerësimit dhe administrimit të provave, pas mbajtjes së seancës për shqyrtim kryesor ka nxjerr aktgjykimin e atakuar C.nr.19/2021, të datës 08.02.2022, me të cilin e ka refuzuar në tërësi kërkesëpadinë e paditësve duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimit.

Në arsyetim të aktgjykimit gjykata e shkallës së parë, ndër të tjera ka theksuar se: për vërtetimin e drejtë të gjendjes faktike gjykata ka administruar këto prova: aktvendimin për shqiptimin e masës disiplinore nr. ... të datës 26.12.2008, vendimin e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës i Kosovës me nr. ..., të datës 16.03.2009, vendimin për përfundimin e marrëdhënies së punës ... të datës 15.05.2009, konkluzionin e GJK-Viti E nr.132/2019, të datës 04.05.2009, kërkesën për komandantin SP-V. me nr. ... të datës 18.05.2009, deklaratën e ish kryetarit të komisionit disiplinor, z. M. S., deklarata e D. Xh. të datës 15.05.2009 dhe 18.05.2009, të dhënë për mediat e shkruara dhe elektronike si K., Radiotelevizioni I. dhe V., aktgjykimin e GJTH - Gjilan P.nr.613/2008 të datës 06.02.2014, i formës së prerë nga data 27.10.2014, raportet mjekësore për paditësin e parë dhe atë Shërbimi Ambulantor Kardiologjik “...” të datës 26.11.2008, raportin e datës 27.11.2008 të ordinancës neuropsikiatrike “...”, raportin e QKMF-së në Viti të datës 02.12.2008, raportin e ambulantes specialistike internistike “...” të datës 03.12.2009, raportin nga laboratorin me nr. ..., raportin kthyes nga laboratorin ..., analiza biokimike të datës 29.09.2012, raporti i Shërbimit Ambulantor Kardiologjik të datës 10.05.2010, raportin e Shërbimit

Ambulantor Kardiologjik, analizat nga laboratoritë “...” në Gj. të datës 29.06.2015, raportin e QKMF-së, në V. me nr. ... të datës 16.06.2014, raportin nga konsulta të datës 16.06.2014, analizën laboratorike të datës 20.02.2014, analizën biokimike të datës 25.02.2012 dhe analizën nga laboratoritë “...” të datës 03.03.2015, raportet mjekësore për paditësen e dytë raportin specialistik të datës 03.12.2009, raportin nga Qendra Diagnostike Terapeutike “...”, të datës 20.12.2014, analizën laboratorike nga “...” të datës 20.12.2014, raportin nga Qendra Diagnostike Terapeutike të datës 29.09.2012, raportin nga Qendra Diagnostike Terapeutike “...” të datës 25.02.2012, raportin nga Qendra Diagnostike Terapeutike të datës 13.04.2013, raportin nga Qendra Diagnostike Terapeutike të datës 16.04.2014 dhe ekspertizën e ekspertit psikiatër nga Dr. F. D. .

Ka theksuar se nga provat e administruara materiale, gjykata ka ardhur në përfundim se kërkesëpadia e paditësve duhet të refuzohet, për shkak të mungesës së legjitimitetit të të paditurës. Paditësit kanë pretenduar, se për shkak të procedurave të kundërligjshme, fillimisht disiplinore e pastaj edhe penale, që ishin ndërmarrë kundër paditësit të parë, përveç këtij të fundit i cili i ka qenë subjekt i këtyre procedurave, edhe paditësit e tjerë kanë përjetuar dhimbje shpirtërore. Gjkata ka vërtetuar se veprimet e ndërmarra në procedurën disiplinore kanë përfunduar në favor të paditësit të parë dhe është kompensuar me të gjitha pagat fakt jo kontestues për palët ndërgjyqëse. Ndërsa, për pretendimet se procedurat disiplinore ishin të motivuara ndaj paditësit të parë, gjykata ka vlerësuar se Komuna e Vitisë nuk ka përgjegjësi për veprimet që i ka ndërmarrë D. Xh.. Gjkata e ka vlerësuar edhe deklaratën e M. S., në të cilën janë paraqitur pretendime për ndërhyrje në vullnetin e tij nga ish Kryetari, nën Kryetari dhe D. Xh., mirëpo, edhe kjo ka qenë pa ndikim në vendimin e gjykatës. Për më tepër, nëse pretendimet në këtë deklaratë kanë qenë të vërteta e që krahasuar me vendimin e Komisionit Disiplinor vërtetë pjesa fjalisë është e fshirë dhe anash saj e ka një nënshkrim të palexueshëm, i kanë tejkaluar përgjegjësitë zyrtare të personave që kanë ndërhyrë në vullnetin e Kryetarit dhe anëtarit të Komisionit, dhe për këtë paditësi ka mundur që të kërkojë përgjegjësi individuale kundër këtyre personave.

Ndërsa, me aktgjykimin P.nr. 897/2013, të datës 03.11.2014, i formës së prerë nga data 27.10.2014, është vërtetuar se paditësi H. Y. ishte liruar nga akuza për shkak të veprës penale pengim i personit zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare. Pretendimet e akuzës kishin të bënin se kinse më datë 24.11.2008, tani paditësi H. Y., i kishte penguar personat zyrtar, ndër ta, edhe D. Xh., në kryerjen e detyrave zyrtare. Marrë parasysh fillimin e procedurës penale dhe përfundimin e saj, është vërtetuar se aktakuza në gjykatë ishte dorëzuar më datë 17.12.2008, dhe procedura kishte zgjatur 6 vite.

Pavarësisht kësaj, gjykata ka vlerësuar se të paditurës Komuna e Vitisë i mungon legjitimiteti real pasiv, nisur nga fakti se padia është dorëzuar pas përfundimit të kësaj procedure, dhe e paditura nuk mund të mbahet përgjegjëse sepse janë organet e ndjekjes ato që vendosin për fillimin ose jo të ndjekjes penale kundër personit të caktuar. Fakti që paditësi i parë, me aktgjykim të formës së prerë është liruar nga vepra penale e pengimit të personit zyrtar, nuk e bën përgjegjëse të paditurën Komunën e Vitisë për dhimbjet e pretenduara shpirtërore nga ngritja e propozim akuzës e deri në përfundimin e kësaj procedurë me aktgjykim të formës së prerë.

Vepra penale për të cilën paditësi i parë është akuzuar ndiqet sipas detyrës zyrtare andaj, ka qenë vlerësim i Prokurorisë për ngritjen e propozim akuzës e jo i të paditurës, Komuna e Vitisë.

Paditësi i parë, ka pretenduar se edhe procedura penale ka qenë e motivuar ndaj tij. Lidhur me këtë, gjykata vlerëson se paditësi, ka mundur që të filloj procedurë penale për lajmërim të rrejshëm kundër personit që fillimisht e ka lajmëruar paditësin e parë në polici për veprën penale për të cilën, ky i fundit ishte liruar me aktgjykim të formës së prerë, e pastaj të krijoj bazë ligjore për padi. Sipas pretendimeve, procedura penale ishte kurdisur nga D. Xh. në koordinim me Policinë në Viti. Përkundër këtyre pretendimeve, paditësi ka zgjedhur që të kërkoj nga e paditura Komuna e Vitisë, kompensimin e dëmit, për veprime individuale të personave që në atë kohë mbanin funksione publike. Po ashtu, edhe për pretendimet se në publik ishte folur për personalitetin e paditësit të parë, dhe me këto veprime ishte cenuar personaliteti i tij, paditësi ka mundur që ta padisë personin i cili publikisht ka folur për të sepse, fakti që D. Xh., ka qenë udhëheqës i Drejtorisë nuk e bën automatikisht përgjegjëse Komunën e Vitisë për qëndrime dhe fjalime që i tejkalojnë autorizimet publike.

Duke qenë se në rigjykim, përfaqësuesja e të paditurës, në fjalën përfundimtare nuk e ka kundërshtuar bazën ligjore të kërkesëpadiës por vetëm lartësinë e kërkesave, gjykata duke u bazuar në 3.3 të LPK-së, sipas të cilit “Gjykata nuk do t'i miratojë disponimet e palëve që janë në kundërshtim me: [...] b) dispozitat ligjore”, nuk e miratoi pohimin e përfaqësueses së të paditurës lidhur me mos kontestimin e bazës ligjore, për faktin se një pohim i tillë është në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi. Deri të ky përfundim, gjykata ka ardhur duke u bazuar në të gjitha provat materiale të administruara e po ashtu edhe në pretendimet e palëve deri para kësaj deklarate nga përfaqësuesja e të paditurës.

Edhe kërkesëpadia e paditësve F., S., R. dhe V. Y., është vlerësuar si e pa bazuar në ligj. Këta paditës kërkesën e tyre e kanë ndërlidhur me faktin se janë në bashkësi familjare me paditësin e parë, e mbi bazë të njëjtën, edhe kishin përjetuar dhimbje shpirtërore. Në gjithë ngjarjen e prezantuar, subjekt i procedurave ka qenë vetëm paditësi i parë, e askund me asnjë veprim apo deklaratë nuk është përmendur ndonjëri nga këta paditës.

Për mënyrën e vendosjes si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar, gjykata e shkallës së parë, i është referuar nenit 154 dhe 172 të LMD-së të vitit 1978 dhe nenit 2, 3.3 dhe 143 të LPK-së. Vendimin lidhur me shpenzimet e procedurës e ka mbështetur në nenin 450 të LPK-së.

Kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë, paditësit kanë paraqitur ankesë, ndërsa gjykata e shkallës së dytë me aktgjykimin e saj Ac.nr.1848/2022, të datës 18.07.2024, ka vendosur që ta refuzojë ankesën e të paditurës, ndërsa aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, e ka vërtetua, duke vendosur decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar.

Gjykata e Apelit në arsyetim të aktgjykimit ndër të tjera ka theksuar se: nisur nga kjo gjendje e çështjes, Gjykata e Apelit vlerëson se qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m) i LPK-së dhe se e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 194 të LPK-së, e po ashtu ky aktgjykim nuk

është i përfshirë as në shkelje tjera të dispozitave nga e drejta materiale, të cilat i ka pretenduar pala ankuese me ankesë.

Gjykata Supreme e Kosovës, nuk mund të pranojë qëndrimin juridik të gjykatave të instancave më të ulëta si të drejtë dhe të ligjshëm, ngase sipas vlerësimit të kësaj gjykate aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë dhe të dytë, janë marrë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale dhe si pasojë gjendja faktike nuk është vërtetuar plotësisht dhe se për këtë arsye nuk ekzistojnë kushtet për ndryshimin e aktgjykimit të goditur, për të cilin shkak aktgjykimi i shkallës së parë dhe të dytë është dashur të prishen.

Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme, aktgjykimi i shkallës së parë është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragraf 2 pika n) e lidhur me nenin 182 paragrafi 1, dhe 160 paragraf 4 dhe 5 të LPK-së, për faktin se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë, ka të meta të atilla, për shkak të cilave, nuk mund të ekzaminohet. I njëjti nuk përmban arsye për faktet vendimtare të cilat kanë pasur ndikim në mënyrën e vendosjes dhe ato pak arsye të cilat janë dhënë nga gjykata e shkallës së parë, janë të paqarta, kontradiktore dhe pa mbështetje në provat dhe procesverbalet nga shkresat e lëndës. Nga arsyetimi i aktgjykimit nuk mund të kuptohet se cilat janë pretendimet e palëve lidhur me gjendjen faktike dhe cilat janë të gjeturat e gjykatës. Gjykata nuk ka specifikuar se cilat kanë qenë faktet vendimtare dhe në çfarë mënyre janë vërtetuar faktet e tilla, për të arritur deri të përfundimi mbi refuzimin e kërkesëpadisë. Gjykata i është referuar dispozitave materiale - juridike të cilat i ka cituar si përmbajtje, por nuk ka arsyetuar se si gjendja e fakteve të gjetura nga ana e gjykatës e kualifikuar në raport me normat materiale - juridike jep përfundimin mbi refuzimin e kërkesëpadisë.

Për shkakun e njëjtë edhe aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë është i përfshirë në shkelje të dispozitave të LPK-së, nga neni 182 paragrafi 2 pika n) e lidhur me nenin 182 paragraf 1, dhe 160 paragraf 4 dhe 5 të LPK-së, sepse gjykata e shkallës së dytë nuk ka vlerësuar të gjitha pretendimet ankimore dhe nuk ka arsyetuar vendimin e saj sipas pretendimeve dhe bazave për të cilat edhe sipas detyrës zyrtare ekzaminohet aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë. Gjykata e shkallës së dytë nuk ka dhënë arsyetim për të gjitha pretendimet ankimore duke i vlerësuar në pajtim me dispozitat ligjore, dhe gabimisht ka vlerësuar se pretendimet ankimore janë të pabazuara.

Pra kjo gjykatë vlerëson se Gjykata e Apelit në aktgjykimin e saj nuk ka dhënë arsye në lidhje me pretendimet thelbësore të ngritura nga pala paditëse e që kanë të bëjnë me çështjen e kompensimit të dëmit jomaterial, për shkak të cenimit të nderit, lirive dhe të drejtave të njeriut. Po ashtu në aktgjykimin e shkallës së dytë nuk ka asnjë arsye në lidhje me çështjet e ngritura në ankesë nga pala paditëse, as në aspektin e shkeljeve esenciale të dispozitave procedurale si dhe as në aspektin e aplikimit të gabuar të drejtës materiale. Kjo mënyrë e vendosjes nga gjykata e shkallës së dytë është në kundërshtim me nenin 204 të LPK, i cili ka përcaktuar si obligim për gjykatën e shkallës së dytë që t'i vlerësoj pretendimet ankimore të palëve e të cilat kanë qenë vendimtare për dhënien e vendimit të saj.

Sipas kësaj gjykate, nuk mjafton që gjykata e shkallës së dytë vetëm të konstatoj se nuk ekzistojnë këto shkelje dhe ta përsëritë formulimin e dispozitës ligjore, por është obligim që të paraqes arsye të qarta në lidhje me atë se a ekziston apo jo shkelja e pretenduar nga pala. Duhet pasur parasysh se drejta për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar është pjesë përbërëse dhe e pandarë e së drejtës për një proces të rregullt ligjor, në kuptim të nenit 31 të Kushtetutës së republikës së Kosovës dhe nenit 6 të KEDNJ-së.

Sipas kësaj gjykate, nuk janë dhënë arsye të qarta nga gjykatat e instancës më të ulët në lidhje me faktet thelbësore të çështjes e që kanë të bëjnë me çështjen e kompensimit të dëmit jomaterial, për shkak të cenimit të nderit, lirive dhe të drejtave të njeriut.

Në këtë kontekst nëse i referohemi doktrinës juridike dhe posaçërisht praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, vërehet influenca e të drejtave themelore në sferën e të drejtës private. Pra, ky ndikim i të drejtave themelore në të drejtën private shihet në rastet që kanë të bëjnë me të drejtat e personalitetit, konkretisht me shpërblimin e dëmit jomaterial në rastin e mbrojtjes së të drejtave të personalitetit, dinjitetit dhe reputacionit. Koncepti i dignitas hominis në mendimin klasik romak ka nënkuptuar kryesisht “statusin”. Në fakt, dignitas nuk kufizohet vetëm për njerëzit por aplikohet për institucionet dhe vetë shtetin. Ky koncept i dinjitetit prej kohësh është përfshirë në disa sisteme juridike në kontekstin e së drejtës private, si bazë për sigurimin e mbrojtjes së dinjitetit në kuptimin e “statusit”, “reputacionit”, dhe “privilegjeve”.

Në vendin tonë, dinjiteti i njeriut është ngritur në rang kushtetues, dhe paraqet një prej vlerave themelore mbi të cilën mbështetet rendi juridik kushtetues. Në këtë mënyrë, Kushtetuta ka përcaktuar se, “Dinjiteti i njeriut është i pacenueshëm dhe është bazë e të gjitha të drejtave dhe lirive themelore të njeriut”. Si i tillë, dinjiteti i njeriut hynë në kategorinë e të drejtave absolute dhe se shmangia nga kjo e drejtë nuk justifikohet në asnjë rrethanë, madje edhe rrethana të jashtëzakonshme qofshin ato.

Sa i përket mbrojtjes së ofruar nga KEDNJ, edhe pse në dispozitat e saj (përveç preambulës) dinjitetin njerëzor nuk e përmend shprehimisht, megjithatë, sipas praktikës gjyqësore të GJEDNJ, është riafirmuar koncepti se respektimi i dinjitetit të njeriut është vet thelbi i konventës.

Në të drejtën moderne është përfshirë koncepti i përgjegjësisë për dëmin jomaterial, i njohur si koncepti objektiv i dëmit jomaterial i cili bazohet në parimin e mbrojtjes së të drejtave të personalitetit. Më saktësisht, koncepti objektiv i dëmit jopasuror bazohet në rregullin se çdo shkelje e të drejtave të personalitetit përbën në vetvete një dëm jopasuror.

Në këtë mënyrë, kur vjen në shprehje cenimi i dinjitetit të njeriut, GJEDNJ ka përcaktuar inter alia se kushdo që është ndaluar në kushte që nuk respektojnë dinjitetin personal të individit duhet të jetë në gjendje të marrë shpërblim adekuat. Lidhur me këtë, qëndrimi i praktikës gjyqësore të GJEDNJ, në rastet e cenimit të dinjitetit njeh si mjet juridik, shpërblimin e dëmit jomaterial.

Në anën tjetër, GJEDNJ në praktikën e saj gjyqësore, mbrojtjes së reputacionit i ka kushtuar kujdes të veçantë, dhe atë përmes sigurimit të mjetit efektiv juridik në rastet e cenimit të reputacionit. Në këtë mënyrë, sipas praktikës gjyqësore, e drejta për mbrojtjen e reputacionit është e drejtë e mbrojtur sipas nenit 8 të KEDNJ, si pjesë e të drejtës për respektimin e jetës private. Dhe, në mënyrë që të vie në shprehje efekti i këtij neni, sulmi ndaj reputacionit të ndonjë

personi duhet të arrij një nivel të caktuar të seriozitetit, dhe të behet në një mënyrë që shkakton paragjykim ndaj gëzimit personal të së drejtës për respektimin e jetës private, (Libicki v. Poland).

Humbja e reputacionit vjen shprehje në shumicën e rasteve kur ndodh publikimi i informacioneve rreth jetës private të ndonjë personi, dhe atë përmes artikujve të të përditshmëve apo edhe në ndonjë formë tjetër. Mirëpo, në mënyrë që gjykata të marr në shqyrtim çështjen për cenimin e reputacionit, fillimisht aplikuesi duhet të dëshmoj se shteti nuk i ka ofruar mbrojtje të mjaftueshme, dhe se kjo ka rezultuar në shkeljen e të drejtës për mbrojtjen e reputacionit.

Në rastin, Mas Gavarró v. Spain, shteti spanjoll kishte theksuar se, pala është dashur që të parashtrij padi me kërkesë për korrektimin e publikimit brenda afatit ligjor, apo të inicioj procedurë të veçantë për mbrojtjen e nderit të tij, me qëllim të sigurimit të shpërblimit, për dëmtimin e reputacionit. Megjithatë, duke zgjedhur vetëm rrugën penale, i njëjti kishte privuar vetveten nga mundësia e sigurimit të shpërblimit, për shkeljen e pretenduar në procedurë civile.

Nëse i referohemi dispozitave të LMD-së, rezulton se: kompensimi i dëmit jomaterial për shkak të cenimit të autoritetit/nderit është përcaktuar me nenin 200 paragrafi 1 i LMD-së. Për të ekzistuar mundësia e shpërblimit të këtij dëmi duhet të plotësohen këto parakushte: a) të shkaktohet cenimi i autoritetit, nderit të njeriut, b) të shkaktojë vuajtje psikike të i dëmtuari, c) kjo vuajtje të ketë intensitet të caktuar dhe kohëzgjatje të caktuar, d) të jetë shkaktuar me fajin e dëmtuesit, e) të ekzistojë lidhja kauzale midis këtij cenimi dhe dëmit të shkaktuar, dhe f) nga ky cenim të shkaktohet dëmi jomaterial. Nga kjo rezulton se nga gjykatat e instancës më të ulët në lidhje me faktet thelbësore të çështjes e që kanë të bëjnë me çështjen e kompensimit të dëmit jomaterial, për shkak të cenimet të nderit, lirive dhe të drejtave të njeriut.

Përveç të cekurave kjo gjykatë, tani për tani nuk mund të pranoj përfundimin dhe qëndrimin juridik i gjykatës së shkallës së parë dhe as të dytë, lidhur me refuzimin e kërkesëpadisë së paditësve, për shkak të mungesës së legjitimitetit pasiv të të paditurës, për arsye se:

Në këtë rast duhet të ndahet pjesa e mungesës së legjitimitetit materialo-juridik (përgjegjësia në kuptimin materialo-juridik, nga mungesa e legjitimiteti proceduralo-juridik (zotësia për të qenë palë në procedurë në kuptim të nenit 73 të LPK-së, si prezumim procedural negativ, për lejshmerin e procesit) sepse janë dy çështje të ndara, gjë që gjykatat e instancave më të ulëta nuk e kanë bërë një gjë të tillë. Ndërsa çështjen nëse është përgjegjëse për kompensimin e dëmit paditësve apo jo, gjykata e shkallës së parë duhet ta vërtetoj në bazë të provave që gjenden në shkresat e lëndës dhe provat e tjera eventuale që do ti paraqesin palët gjatë procedurës.

Gjykata e shkallës së parë në rigjykim, udhëzohet që ti evitojë shkeljet e theksuara si më lartë fillimisht sa i përket shkeljeve të dispozitave të LPK-së, në atë mënyrë që të vlerësojë kushtet nga të cilat varet zhvillimi i procedurës. Pastaj gjykata do të ndërmerri hapat tjerë procedural në drejtim të nxjerrjes dhe administrimit të provave rreth vërtetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike, të caktoi shqyrtimin kryesorë dhe sipas propozimit të palëve, të nxjerr prova në drejtim të vërtetimit të fakteve të theksuara më lartë, e pastaj përmes vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, duke aplikuar normat e të drejtës materiale, të ligjit (ligjeve) të cilat kanë qenë në fuqi në kohën kur pretendohet që janë krijuar raportet juridike në mes të palëve, të ketë mundësi që në mënyrë të drejtë dhe objektive të vlerësoj rrethanat e çështjes lëndore e pastaj të

Numri i lëndës: 2021:004985

Datë: 22.11.2024

Numri i dokumentit: 06492272

vendos në mënyrë meritore lidhur me kërkesëpadinë e paditësve dhe pa marrë parasysh cili do të jetë përfundimi lidhur me çështjen lëndore, të evitojë shkeljet procedurale të konstatuara si më lartë nga gjykata ankimore, ashtu që vendimin të cilin do ta bie do duhet të përmbajë të gjitha elementet e kërkuara ligjore siç përcaktohet me dispozitën e nenit 160 të LPK-së.

Nga arsyet e paraqitura më lartë dhe në pajtim me nenin 224 paragrafi 2 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA SUPREME E KOSOVËS NË PRISHTINË**

Rev.nr.477/24, datë 19.11.2024.

Kryetar i kolegjit  
Rrustem Thaqi